



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:300086
Datë: 13.02.2021
Numri i dokumentit: 01505037

C. nr. 01/20

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN -Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, përmes gjyqtarës Florije Qerimi, me bashkëpunëtorin profesional Baki Sylejmani, në çështjen juridike kontestimore të paditëses S. A. nga fshati ..., Komuna e Gjilanit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Enver Halili avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Burim Maliqi nga Gjilani, Zyrtar i Lartë Ligjor te e paditura, me objekt kontesti për kompensimin e shpenzimeve për ushqim, paga jubilarë dhe shpenzimet e udhëtimit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, në prezencën e të autorizuarve të palëve ndërgjyqjësë, më datën 26.01.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar, kërkesëpadia e paditëses S. A. nga fshati ..., Komuna e Gjilanit dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Gjilanit – Drejtoria e Arsimit që t’ia kompensojë paditëses në emër të kompensimit të ushqimit për 516 ditë pune, shumën e të hollave në lartësi prej 1032.00 €, si dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit shumën e të hollave në lartësi prej 95.90 (për 137 ditë pune për udhëtim), respektivisht shumën e përgjithshme prej 1,127.90 €, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore në shumë prej 260.00 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotëfuqishmërisë të këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm dhe atë në afat prej 7 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin të përmbarimit.

II. REFUZOHET SI E PABAZUAR - pjesa tjetër e kërkesëpadiisë së paditëses në shumë prej 210.50 € në emër të shpërblimit jubilar e kërkuar më tepër se shuma e gjykuar .

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqjësë:

Paditësja S. A. nga fshati ..., Komuna e Gjilanit, përmes të autorizuarit së saj Av.Enver Halili në këtë gjykatë me datë 30.12.2019 ka paraqitur padi kundër Komunës së Gjilanit – Drejtorisë së Arsimit, me bazë juridike kompensim i borxhit duke theksuar se paditësja ka punuar në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët “...” në fshatin ..., që nga viti 2001, në pozitën e

mësimdhënëses të lëndës së dhe e njëjta ka realizuar pagën neto prej 458,59 € dhe pagën bruto prej 513,22 €, sipas Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e duke u bazuar në nenin 35, alinea 8, ka mbi 10 vite përvojë pune dhe për këtë kanë kërkuar që të i njihet e drejta në shpërblimin jubilar në shumën prej 50 % të një page bazë, e po ashtu ka kërkuar edhe kompensimin e ushqimit gjatë ditëve të punës. I njëjti në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datën 25.01.2020 ka bërë ndryshimin e padisë edhe sa i përketë udhëtimit pasi që e njëjta punon edhe në SHFMU në fshatin Kemtovic dhe udhëton me autobus ashtu dhe ka kërkuar që të aprovohet kërkespadija e paditëses dhe të obligohet e paditura Komuna e Gjilanit – Drejtoria e Arsimit që t’ia kompensojë paditëses në emër të kompensimit të ushqimit për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri më dt.11.03.2020, shumën e të hollave në lartësi prej 1032.00 € (për 516 ditë), në emër të kompensimit për vitet jubilarë të punësimit pasi që e njëjta ka 17 vite përvojë pune dhe atë nga të ardhurat bazë prej 421 € e që të njëjtës i takojnë 50% respektivisht shumën e të hollave në lartësi prej 210.50 €, si dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit shumën e të hollave në lartësi prej 95.90 € (për 137 ditë pune për udhëtim), respektivisht shumën e përgjithshme prej 1,338.40 €, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

E paditura në përgjigje në padi e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses për arsye se paditësja i kërkesëpadinë e saj e bazon në Kontratën e Përgjithshme Kolektive të Kosovës e miratuar dhe nënshkruar nga MASHT (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë) dhe SBASHK (Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës), respektivisht në dispozitat e nenit 35 pika 8 dhe nenit 35 pika 6 dhe 7 të kësaj kontrate, gjersa ka konsideruar se kjo kontratë nuk prodhon efekte juridike dhe nuk krijojnë të drejta dhe detyrime ndaj Komunes së Gjilanit si e paditur në këtë rast. Po ashtu ka theksuar se kjo kontratë nuk është në fuqi për disa arsye konkrete: Ligji Nr.04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga Shteti i dt. 06.05.2014 nuk ka paraparë një të drejtë të tillë sipas padisë dhe kërkesëpadisë dhe se çdo marrëveshje që parasheh të drejta jashtë këtij ligji nuk prodhon kurrfarë efekti juridik. Tutje ka theksuar se, kjo kontratë kolektive në hyrje të saj bazohet në Ligjin e Punës i cili nuk parasheh një të drejtë të tillë të beneficioneve, pasi neni 77 i këtij ligji potencon se pensioni i vjetërsisë dhe i parakohshëm rregullohen me ligj të veçantë. Pagat jubilarë sipas Kontrates Kolektive të Arsimit mund të realizohen pas çdo 10 viteve dhe se afati i realizimit të kësaj kërkesë është 30 ditë nga koha e të drejtës për kompensim, ndërsa në rastin konkret kemi tejkalim të afatit ligjor të realizimit të kësaj kërkesë dmth. paditësi nuk e ka kërkuar realizimin e kësaj kërkesë në afat prej 30 ditësh, ndërsa sipas LMD-së, neni 353 par.3 dhe neni 357 par.1 dhe neni 87 të Ligjit të Punës, kemi parashkrim të kërkesës për arsye se tashmë paditësja ka 17 vite përvojë të punës ndërsa dihet se një e drejtë e tillë i ka takuar pasi që paditësja i ka bërë 10 vite përvojë të punës, që do të thotë se një kërkesë të tillë e ka bërë pas 5 viteve, po ashtu në nenin 90 pika 8 e Ligjit të Punës, për të qenë kontrata në fuqi ligjore duhet të jetë e regjistruar në MPMS, kurse në rastin konkret kjo kontratë nuk është e regjistruar në organin e lartëcekur, dhe në fund ka shtuar se nuk janë shterrur mjetet juridike sipas procedurës administrative me qëllim që të inicohet procedura gjyqësore për realizimin e të drejtës së paditëses, prandaj kanë konsideruar se baza juridike e kësaj padie nuk është e qëndrueshme në aspektin juridik.

I autorizuari i paditëses në seancën e shqyrtimit përgatitor, kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar që mbetet pranë ndryshimit të padisë si dhe zgjerimit të së njëjtës në shqyrtimin kryesor. I autorizuari i paditëses për vërtetimin e fakteve të parashtruara me padi dhe kërkesëpadi i ka propozuar gjykatës që në këtë çështje kontestimore, si prova të administrohen të gjitha provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës po ashtu i njëjti në fund ka deklaruar se i kërkon shpenzimet e procedurës kontestimore duke i specifikuar edhe atë për përpilimin e padisë shumë prej 104 €, për taksë gjyqësore 21 €, si dhe për përfaqësim në një seancë shumë prej 135 € të TA-së, respektivisht shumë prej 260 €.

I autorizuari i të paditurës në seancën e shqyrtimit përgatitor, kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka mbetur pranë përgjigjes në padi dhe thënieve të deklaruara në këtë seancë, ku e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, duke konsideruar se kërkesa e paditëses sa i përket shpërblimit jubilar në bazë të nenit 353 par.3 dhe nenit 357 par.1 të LMD-së të vitit 2012, si dhe nenit 87 të Ligjit të Punës, kemi parashkrim të kërkesës së paditëses pasi që e njëjta i ka mbushur 17 vite përvojë pune, ndërsa dihet se një e drejtë e tillë i ka takuar para 7 viteve, e duke pasur parasysh se shpërblimet jubilarë paguhën në çdo 7 mars të secilit vit, rrjedhë se në atë kohë nuk ka qenë në fuqi asnjë ligj, kontratë kolektive apo ndonjë akt tjetër nënligjor i cili e kishte paraparë shpërblimin jubilar për të punësuarit në arsim, ndërsa kontrata kolektive në të cilën paditësja e bazon kërkesën e saj për shpërblimin jubilar nuk parasheh implemtim retroaktiv të së njëjtës. Po ashtu ka konsideruar se kjo kërkesë është vjetruar dhe konform nenit 87 pika 1 të Ligjit të Punës.

Për palët ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se paditësja është në marrëdhënie pune të e paditura nga periudha kontestuese. Po ashtu nuk është kontestues për të paditurën edhe ditët e pranisë në punë për paditësen për periudhën e kërkuar. Po ashtu, për të paditurën nuk është kontestuese as lartësia e kërkesëpadisë. Mirëpo, kontestuesë për palën e paditur është baza juridike e padisë, pasi që konsideronë se paditura nuk është përgjegjëse për përmbushjen e detyrimit të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit, edhe atë nga arsyet e cekura sikurse në përgjigje në padi, si dhe prapësimi tyre i ngritur sa i përket parashkrimit të kërkesës së paditëses për shpërblimin jubilar.

Provat e administruara në shqyrtimin kryesor :

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore në procedurën e provave i ka administruar këto prova: Kontrata e punës për mësimdhënës në kohë të caktuar me nr.të protokollit 159 e dt.01.09.2018 në emër të paditëses; Lista e pagave të lëshuar në emër të paditëses nga Buxheti i Republikës së Kosovës; Vërtetimin me nr.të protokollit 245 e dt.07.02.2020 e që ka të bëjë me ditët e punës nga data 18.04.2017 e deri më datën 06.02.2020 e që gjithësejtë bëjnë 516 ditë pune; Njoftimin nga SHFMU "Skënderbeu" në fshatin Përlepnice nr.242/2 nga data 07.02.2020 me të cilën dëshmohet se shkolla nuk ka kuzhinë; Vërtetimi tatimor në emër të paditëses e lëshuar me dt.11.02.2020; Vërtetimin nga SHFMU "... " në ... me nr.të protokollit 295/2 e dt.11.03.2020; Vërtetimi nga NT."Egnatia" e dt.12.03.2020; Çmimorja e transportit nga linjat komunale e dt.05.03.2020 nga Shoqata e Transportit Rrugor të Udhëtarëve; Çertifikata e vendbanimit në emër të paditëses e

lëshuar nga ZGJC-Përlepnice-Gjilan e dt.19.06.2020, Kërkesën e grupit të punëtorëve dorëzuar të paditurës për kom-pesim e dt.23.12.2019; Përgjigjen e kërkesës së paditëses nga DKA e dt.09.04.2020;

Pasi që gjykata e bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, konform dispozitës së nenit 8, të LPK-së, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi për këto arsye:

-Nga Kontrata e punës për mësimdhënës në kohë të caktuar me nr.të protokollit 159 e dt.01.09.2018, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka themeluar marrëdhënie pune me të paditurën me datën 01.09.2018, me kohë të caktuar, me pozitë të punës mësimdhënëse e lëndës së për kohë të caktuar për periudhën kohore nga dt.01.09.2018 deri 31.08.2019, në SHFMU “...” në fshatin

-Nga lista e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës, për paditësen S..A. me nr. gjykata e vërtetoi faktin se paditësja realizon pagë mujore neto në shumë prej 458,69 €, ndërsa paga bazë e së njëjtës është shuma prej 421 €, ndërsa përvojë pune ka mbi 17 vite..

-Nga Vërtetimi nr.të protokollit 245 e dt.07.02.2020 e që ka të bëjë me ditët e punës, gjykata vërtetoi faktin se paditësja nga data 18.04.2017 e deri më datën 06.02.2020 ka 516 ditë pune, në vendin e saj të punës.

-Nga Njoftimi nga SHFMU “...” në .., për kuzhinën e shkollës, me numër 242/2, e datës 07.02.2020, gjykata vërtetoi faktin se kjo shkollë së bashku me dy paralelet e saja të ndara nuk ka kuzhinë për përgaditjen e ushqimit dhe se asnjë punëtorë i tyre nuk shërbehet në shkollë në ushqim dhe as nuk ka kushte për përgaditje.

-Nga Vërtetimin nga SHFMU “...” në ... me nr.të protokollit 295/2 e dt.11.03.2020, gjykata vërtetoi faktin se e njëjta në total i ka 137 ditë të udhëtimit në relacionin dhe anasjelltas.

-Nga Çmimorja e Transportit nga linjat komuale e dt.05.03.2020 nga Shoqata e Transportit Rrugor të Udhëtarëve „ANAMORAVA”, gjykata vërtetoi faktin se çmimi i biletës një drejtmëshe në relacionin Përlepnice-Kmetovc dhe anasjelltas kushton 1 € për të dy drejtimet.

-Nga Çertifikata e vendbanimit në emër të paditëses e lëshuar nga ZGJC-...-Gjilan e dt.19.06.2020, gjykata vërtetoi faktin se paditësja vendbanimin e ka në fshatin, Komuna e Gjilanit.

Nga Përgjigjësja e kërkesës së paditëses nga DKA e dt.09.04.2020, gjykata vërtetoi faktin se Komuna e Gjilanit nuk ka mjete financiare për të kompensuar shpenzimet e udhëtimit, të ushqimit dhe pagën jubilarë dhe në mungesë të alokimit të mjeteve nga ana e institucioneve përgjegjëse Komuna e Gjilanit, rrezikon jo vetëm planifikimin e buxhetit por edhe vetë procesin edukativo-arsimor.

Baza juridike:

Gjykata me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditëses dhe përcaktimit të lartësisë për shujtën ditore në shumë prej 2 euro në ditë, për 516 ditë pune dhe të udhëtimit, është bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017, e nënshkruar në mes të Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (SBASHK) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT).

Bazuar në nenin 35, paragrafi 7, të Kontratës Kolektive të lartëcekur i cili parasheh se *“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarëve, përmes restaurantit a kuzhinës, osë në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin e ushqimit”*, në këtë dispozitë përcaktohen të drejtat e të punësuarve për kompenzimin për ushqim ditor gjatë punës, e që është paraparë që për një ditë pune të punësuarit t’i kompenzohet nga 2 euro, në këtë kuptim paditësja rezulton të ketë kaluar 516 ditë pune, për vitet shkollore 2016 – 2017, 2017 – 2018, 2018 – 2019 dhe 2019 – 2020, fakt ky i vërtetuar nga Vërtetimi me nr.te prtollit 245, nga data 18.04.2017 e deri me datën 06.02.2020, e po ashtu nga njoftimi nga SHFMU “...” në, për kuzhinën e shkollës, gjykata ka gjetur se e njejta nuk e ka të rregulluar përgaditjen e ushqimit dhe asnjë punëtorit nuk shërbehet në shkollë me ushqim e po ashtu nuk kanë as kushte për përgaditjen e të njejtit, ku në lidhje me këtë kërkesë të paditëses, shuma e përgjithshme është 1032 €, shumë kjo e vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Kërkesën e paditëses për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, gjykata e aprovoj në tërësi si të bazuar në shumën prej 95.90 €, dhe kjo bazuar në nenin 35 par.5 i Kontratës Kolektive të lartëcekur, ku në bazë të këtij neni është përcaktuar *„ punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës së përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70 % të biletave të trafikut urban”* ku cmimi i biletës sa i përket udhëtimit të paditëses në dz drejtime ka qenë 1 €, fakt ky i vërtetuar nga Vertetimi me nr.256/2 nga dt.11.03.2020 i cili ka te bëj me ditët udhëtimit në shkollën fillore në fshatin Kmetovc dhe anasjelltas dhe Dëshmia-çmimorja e udhëtimit e lëshuar nga Shoqata e Transportit Rrugor të Udhëtarëve “Anamorava” në Gjilan e vërtetuar tek noteri.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ashtu që pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditëses të kërkuar më tepër se shuma e gjykuar në shumë prej 210.50 €, në emër të shpërblimit jubilar e refuzoi si të pabazuar, kjo për faktin se paditësja ka filluar punën si mësidhënëse e lëndës së ... në vitin 2001, ndërsa jubileun 10 vjeçar e ka patur në vitin 2011, ndërsa në këtë kohë nuk ka qenë në fuqi asnjë Kontratë e Kolektive e Arsimit, e që kontrata e parë ka hyrë në fuqi më datën 11.04.2014 dhe se në atë kohë nuk ka pasur bazë ligjore për të kërkuar një të drejtë të tillë. Kontrata Kolektive e Përgjithshme ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015 dhe ka qenë valide deri më datën 31.12.2017. Me kontratë të përgjithshme kolektive dhe kontratë sektoriale parashihen kushtet të cilat duhet plotësuar në mënyrë që të

paguhen shpërblimet jubilarë të punësimt tek punëdhënsi i fundit, ndërsa në rastin konkret paditësja me datë 31.12.2020 ka kërkuar shpërblimin jubilar për 10 vite përvojë pune të cilat i ka arrit në vitin 2011, paditësja është e nevojshme për të realizuar një të drejtë të tillë, të ketë edhe bazën ligjore që të kërkoj shpërblimin jubilar e që nga kjo rrjedhë edhe konkludimi që në mungesë të bazës ligjore të refuzohet pjesa tjetër e kërkesëpadisë në shumë prej 210.50 € e kërkuar me tepër se shuma e gjykuar.

Duke u bazuar në dispozitën e nenin 90, paragrafi 6, të Ligjit të Punës me Nr.03/L-212, përcaktohet se *“Marrëveshja Kolektive nuk mund të përfshijë dispozita të tilla që kufizojnë të drejtat e të punësuarve që kanë si pasojë kushte më pak të favorshme të punës sesa ato të përcaktuara në këtë ligj”*, poashtu konform dispozitës së nenit 8, paragrafi 1, të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve me NR.04/L-077, ku përcaktohet se *“Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit”*, gjykata mbi bazën e këtyre dispozitave ligjore të lartëcekura e aprovoj kërkesëpadinë e paditëses pjesërisht si të bazuar dhe e detyroj të paditurën që ta përmbush detyrimin e saj ndaj paditëses, ndërsa kërkesën më tepër se shuma e gjykuar e refuzoi si të pabazuar.

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës :

Andaj, duke u bazuar në dispozitat e lartëcekura të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, dispozitave tjera ligjore të lartëcekura si dhe gjendjen faktike të vërtetuar, gjykata e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses dhe e ka detyruar të paditurën, Komuna e Gjilanit – Drejtoria e Arsimit që t’ia kompensojë paditëses në emër të kompensimit të ushqimit për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri më dt.11.03.2020, shumën e të hollave në lartësi prej 1032.00 € (për 516 ditë), si dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit shumën e të hollave në lartësi prej 95.90 (për 137 ditë pune për udhëtim), respektivisht shumën e përgjithshme prej 1,032.00 €, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm, pasi që nga provat e administruara është vërtetuar fakti se paditësja nga periudha kohore nga data 18.04.2017 e deri më 11.03.2020, ka qenë në vendin e punës për 516 ditë, poashtu, e po ashtu e njejtja ka pasur për detyrim që në bazë të nenit 35 par.5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, t’ia kompensojë paditëses shpenzimet e udhëtimit në shumë prej 95.90 € (për 137 ditë pune për udhëtim – 70% të shumës për 1 €, për të dy drejtimet), ku këtë detyrim e paditura nuk e ka përmbushur, andaj gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Pretendimet e përfaqësuesit të palës së paditur, se kërkesëpadia e paditëses për kompezimin e ushqimit për ditët në punë dhe kompensimi e udhëtimit duhet të refuzohet si e tillë, nuk qëndron dhe se për gjykatën këto pretendime ishin të pa bazuara, për faktin se me nenin 2, të Kontratës Kolektive të lartëcekur, të gjitha Drejtorit Komunale të Arsimit, në Kosovë, janë të obliguara ta zbatojnë Kontratën Kolektive të lartëcekur dhe me kohë të planifikojnë mjete buxhetore për këto raste, poashtu duke u bazuar në nenin 6, paragrafi 4, pika 2, të kësaj

kontrate Kolektive të lartëcekur, paditësja, me pozitë të punës mësimdhënëse e lëndës së .. hynë në kuadër të përfituesve të të drejtave që rrjedhin nga kjo Kontratë.

Po ashtu për gjykatën është i pabazuar edhe pretendimi tjetër i të paditurës se Kontrata Kolektive e Arsimit Parauniversitar nuk prodhon efekt për të paditurën, ngase një pretendim i tillë është në kundërshtim me Ligjin për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës me nr.03L-068, ku në nenin 5 të këtij ligji janë të parapara kompetencat e komunave sa i përket punësimit të mësimdhënësve dhe pagesës së tyre e rrjedhimisht edhe detyrimet e parapara me Kontratë bien në barrë të të paditurës. Pos tjerash, Gjykata konsideron se një pretendim i tillë është i pabazuar edhe nga fakti se KKAK është lidhur në nivel vendi sipas dispozitave në Ligjin e Punës (nenin 90 i këtij Ligji), e po ashtu, sipas edhe me dispozitën e nenit 2 të KKAK-së është parapare se dispozitat e KKAK janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet e Arsimit ku bënë pjesë edhe paditësja. Pastaj është e caktuar qartë se dispozitat e kësaj Kontrate janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e arsimit, gjegjësisht komunat-DKA-të ku në këtë rast është e paditura (neni 2 i KKAK-së). Prandaj nga keto arsye gjykata vlereson se e paditura ka përgjegjësi në përmbushjen e detyrimeve të prcaktuara nga KKAK-se pasi që kjo kontratë është lidhur në nivel vendi dhe në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit të Punës. Sa i përket pretendimit tjetër të paditurës ku ka theksuar se KKAK nuk është regjistruar fare në faqen MPMS, dhe si e tillë nuk duhet të prodhoj efekt juridik, gjykata një pretendim të tillë nuk e mori për bazë, pasi që një pretendim i tillë sipas kësaj gjykate nuk është i bazuar dhe nuk është relevante se a është regjistruar apo jo KKAK në faqen e MPMS, sepse referuar nenin 47 të kësaj Kontrate është paraparë se pas nënshkrimit të kësaj kontrate nga palët e njejta regjistrohet dhe depozitohet në MASHT e jo në ndonjë organ tjetër siç pretendon e paditura, kjo për faktin se kjo kontratë është sektoriale dhe jo e përgjithshme dhe e njejta prodhon efekt juridik vetëm për të punësuarit dhe punëdhënësit në sektorin e arsimit (neni 2 i Kontratës). Si do që të jetë, akti i regjistrimit dhe depozitimi i kontratave, sikurse kjo në rastin konkret i KKAK-së ka qenë përgjegjësi e karakterit administrativ e organit publik kompetent që të njejtën ta regjistroj apo depozitoj, e për të cilat lëshime eventuale nuk mund të kenë konsekuenca të punësuarit, në këtë rast paditësi.

Gjykata në lartësinë e aprovuar për kompensimin e shpenzimeve për ushqim, dhe shpenzimet e udhëtimit, paditëses i'a ka njohur të drejtën e kamatës ligjore prej 8% dhe atë në kuptim të nenit 382 të LMD-së.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi ashtu që duke u mbështetur në nenin 452, paragrafi 1, të LPK-së e detyrojë të paditurën, që paditëses t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 260 €, dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumë prej 104 euro, në emër të taksës gjyqësore për paraqitjen e padisë shumë prej 21 € dhe në emër të përfaqësimit në seancën e shqyrtimit kryesor shumë prej 135 euro.

Duke u bazuar në të lartëcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjykata Themelore në Gjiilan-Departamenti i Përgjithshëm
C.nr. 01/20, me datë 25.01.2021

Gjyqtarja,
Floriqe Qerimi

UDHËZIMI JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë ankese, në afat prej 7 ditëve, pas ditës së pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, nëpërmjet kësaj gjykate.